



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Personel

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 08

Datë: 14-02 2022.

KONTRATË PROKURIMI Nr 04

Komuna e Malishevës (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë; dhe

Ganimet Bajra B.I. (Kombi Taxi Ganimet Bajra) me seli në Malishevë me Nr.biznesi 811151935 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Transporti i nxënësve me kushte të rënda ekonomike në fshatrat

Panorc - Lagja Garaqevë

me numër identifikues: 62500-22-377-2-3-6/62500-22-02-236

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: TRANSPORTI I NXËNËSVE ME KUSHTE TË RËNDA EKONOMIKE NË FSHATIN PANORC - LAGJA GARAQEVË.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe përfundon me kryerjen e Transporti i nxënësve me kushte të rënda ekonomike.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [shëno numrin] ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së transportit do të jetë: Komuna e Malishevës me fshatin nga të cilët janë nxënësit me kushte të rënda ekonomike do të transportohen prej shtëpis në shkollë dhe anasjellëtas.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 ÇMIMI

3.1. Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **2 754,00€**

(**dymijëeshtatëqindëepesëdhjetëekatëreuro**).

3.2. Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 3.3 Menaxhimi i Kontratës

Menaxhimin e Kontratës Transporti i nxënësve me kushte të rënda ekonomike në fshatin Panorc - Lagja Garaqevë do ta bëjë zyrtari i drejtories së DKA-së **z.Enver Mazreku** i caktuar nga ZKA-ja e AK-së.

Neni 3.4 Obligimet e OE

OE është i obliguar që Transportin e nxënësve me kushte të rënda ekonomike ta kryej në përputhëshmëri me specifikacionin e ofertës. OE është i obliguar që të respektoj orarin e transportit të nxënësve në mënyrë që nxënësit të shkojnë me kohë në mësim por edhe të kthehen me kohë në shtëpi. Kontraktuesi i parë (AK) e ruan të drejtën që t'a ndërprej kontratën me kontraktuesin e dytë për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe afatë .

Neni 3.5 Afati

Fillimi i Shërbimeve të transportit do të fillojë që nga dita e nënshkrimit të kontratës të datës 14.02.2022. Përfundimi do të jetë brenda **102 ditë** mësimi.

Neni 4 PAGESA

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Obligohet kontraktuesi i parë (AK) që pasi t'a pranon raportin e pranimi të Transporti i nxënësve me kushte të rënda ekonomike nga zyrtari përkatës dhe faturën nga kontraktuesi i dytë (OE) t'ia paguaj shumën sipas nen. 3 dhe 3.1 të kësaj kontrate (pagesa kontraktuesit të dytë do të i bëhet në bazë të raportit të zyrtarit **z.Enver Mazreku** .

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 6.2 Rreziqet e OE në komunikacion.

OE është përgjegjës për të gjitha dëmet materiale të cilat mund të shkaktohen gjatë kryerjes së shërbimeve të transportit . Në rast se OE shkakton aksident në komunikacion gjatë transportit të nxënësve përgjegjësia për të gjitha dëmet do të bien mbi OE nese vertetohen me ekspertiz nga eksperti i komunikacionit rrugor se OE është fajtor.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për ____ muaj, pas pranimi të *[shërbimeve]* *[punëve]*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizim.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi

që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Ganimet Bajraj
Pozita:	Menagjer i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

SPECIFIKACION : Transporti i Nxënësve Me Kushte Të Rënda Ekonomike Të Lagjes Garaqevë në Fshatin Panorc

Nr.	Relacioni	Njësia matëse	Nr. i Nxënësve	Çmimi	Ditë	Totali
1.	Relacioni : Lagja Garaqevë - Panorc dhe anashjaletas	nxënës	27	1	102	2,754.00€
Totali:						2,754.00€

